

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT PRISHTINA SH.A.)**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **(70433736-25-810-1-1-1)**

Sa i përket tenderit për **(Furnizimi rehabilitimi dhe avancimi i sistemit të teknologjisë së trajtimit të ujit nëpër IT-UP (Transformator, inventar, pajisje makinerike, elektronike))**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

EJONA SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

ZAHAQ-PEJE
(Adresa)

PEJE
(Vendi)

30000
(Kodi postar)

049137987
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

LIRIE DALIPI PRELVUKAJ
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@ejona.com
(Adresa elektronike)



10.07.2025
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

19.02.2025 Njoftim per kontrat
07.04.2025 Hapja e ofertave
26.05.2025 Vendimi 1
16.06.2025 Vendimi 2
23.06.2025 Kerkesa per Rishqyrtim
30.06.2025 Refuzimi i kerkeses per rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kemi parashtruar kërkesen per rishqyrtim brenda afatit ligjor, ku kemi sqaruar ne detale shkeljet dhe parregullsitet e AK ne vendimin e dyte.

AK e refuzon kërkesen per rishqyrtim, duke mos respektuar rregullat dhe LPP.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojme se jane shkele keto nene te Rregullores se Udhezuesit Operativ te Prokurimit Publik:

- 28. Kriteret e Dhënies së Kontratës

28.1 Autoritetet kontraktuese mund të zgjedhin të bëjnë dhënien e kontratës në bazë të:

- Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ultë ose
- Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm

- 39. Sqarimi i Tenderëve

39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK “Kërkesë për sqarim të tenderit”. Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformes elektronike.

39.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

39.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesat kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

- Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti

kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*






8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Fillimisht kërkesa ka qenë:

Modeli: FDU69-800-23 ose i ngjashëm dhe pastaj komisioni i vlersimit duke ju referuar këtij tipi mundohet që secili parameter pavaresisht që tejkalon ose është e ngjajshme dhe shumicen dermuese edhe e tejkalojnë frekuentorin e kerkuar e merr si jo valide.

Vlenë të thekshohet që i njëjti komision propozon fillimisht kompaninë tonë si ofertë të suksesshme në ndërkohë që komisioni kontakton me kompaninë BAK-ING dhe joshë që të bëjë ankesë **dhe kemi dëshmi të saktë se disa anëtarët e këtij komisioni dhe disa të tjerë jashtë këtij komisioni bëjnë "marrveshje financiare-korrupsion" dhe bazuar me vlerësimin që kanë kryer janë munduar të shpikin gjëra të pavetëta vetëm që ti realizojnë qëllimet e veta, të cilat nuk do të shpalosim këtu por në organet kompetente të cilat do të vërtetojnë këto pretendime.**

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE	
Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit	
Nazmi Gashi	
Ylber Zabergja	
Agim Paloja	
Urim Zogiani	
Data:	11.06.2025
Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit: Avni Gashi	
Nënshkrimi:	
Data:	16/06/2025

Në vazhdim po japim argumentet tona të cilat ky komision ka mundësi me një kërkesë për sqarim të marrë informatat e nevojshme por nuk ka vepruar kështu.

Pasiqë bëhet fjalë për një artikull-frekuentorë në këtë rast dhe për të cilin kemi dorëzuar katalog dhe tipin e ofruar ky komision duke u munduar që të ju ikë argumenteve dhe të



















favorizojë OE të propozuar për kontratë të kohen mundohet të argumentojë që kemi dorezuar katalogje të ndryshme derisa për produktin e ofruar lehtësisht ka mundësi të gjen në faqen e prodhuesit për tipin të cilin kemi prezentu.

Pretendimi 1. Pas vendimit të AK për refuzim të ankesës sonë me datën 16.06.2025 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e OE të propozuar për kontratë dhe të gjeturat janë si në vazhdim:

Në DT tek kërkesat teknike 9.1&9.2 kërkohet që të ketë së paku një referencë :

Kerkesa 3. Operatori Ekonomik	Evidenca 3. (i) nese furnizimi
duhet të paraqesë te Autoriteti Kontraktues dokumentacion që verteton se gjate tri viteve te fundit, duke filluar numerimin mbrapa nga data e ketij njoftimi, ka realizuar se paku një kontratë per furnizime te ngjajshme.	është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben një Letër Reference të leshuar nga ana e AK OSE fletdergese fletpranim ose dokumentit per pranim teknik te pajisieve e cila duhet te jete e nënshkruar nga ana e AK; (ii) nese furnizimi është bërë për një klient privat për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben kopja e cdo dokumenti të nënshkruar nga klienti që evidenton një ekzekutim

Pas shiqimit të ketyre referencave del që ky OE i propozuar për kontratë nuk ka asnjë referencë për punët e kryera të kësaj natyre, për më tepër në 2 prej tyre përmendet frekuentori dhe pas futjes brenda ketyre kontratave gjinden furnizime të kabllove dhe të ngjajshme poashtu edhe nëse mirren si të mirëqena datojnë të viteve 2020-2021 dhe si të tilla nuk e plotësojnë kërkesën e DT për 3 vitet e fundit.

 Furnizim me material harxhues elektrik (KEKO-20-317-121).pdf
 Furnizim me kablo energjetike, kablo për elektromotor dhe konvertor të frekuencave.pdf
 Furnizim me material elektrik (NPB).pdf
 Furnizim me material harxhues elektrik.pdf
 Furnizim me material për ndriqim.pdf
 Furnizim me pjesë për PLC.pdf
 Furnizim me pjesë rezerve për ndriqim.pdf
 Furnizim me shëndrrues të frekuencave.pdf
 Furnizim me smartboard për nevojat e FSK-së.pdf
 Furnizimi dhe montimi i ndërprerësve të fuqisë - LOT 1.pdf
 Furnizimi me njësi kontrolluese.pdf
 Furnizimi me reflektor LED.pdf
 Komuna e Gjakovës.pdf
 LISTA E REFERENCAVE.pdf
 Raporti i pranimit (KABLO OPTIKE).pdf
 Raporti i pranimit për projektin Furnizim me Modem xDSL.pdf
 Raporti i pranimit të situacionit të parë (I-rë) dhe të fundit për projektin Furnizim me material esencial elektrik për SHKK-në.pdf
 Raporti i pranimit të situacionit të parë (I-rë) dhe të fundit për projektin Rregullimi i ndriçimit dhe zëvendësimi i poçave me efikasitet në inst...

Keto kontrata janë të verifikueshme lehtë në E-prokurimin publik dhe në vazhdim po japin argumentet për to:



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

KONTRATË



Numri i kontratës 1: **KEK-21-1241-1-1-C1304**

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a., Rr. Nëna Terezë, nr.36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, nr.i regjistrimit të kompanisë: 811290808, duke iu referuar në vijim si "Autoriteti Kontraktues", në njërën anë, dhe

BAK - ING SH.P.K., Rr. Hakif Zejnullahu, Ulpianë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, nr.i regjistrimit të kompanisë: 810116211 duke iu referuar në vijim si "Furnizuesi", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me kablo energjetike, kablo për elektromotor dhe konvertor të frekuencave, me numër identifikues: Nr. i brendshëm i prokurimit: KEKO-21-110-111(KEK-21-1241-1-1).

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë dërgesa nga Furnizuesi, i furnizimeve sipas ofertës së Furnizuesit në tabelën në **Aneksin 1**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për liferim është: **150 ditë**, pas nënshkrimit të kontratës nga ana e të dy palëve kontraktuese.



Titulli : Furnizimi me kablo energjetike, kablo për elektromotor dhe konvertor të frekuencave
Numri i Prokurimit : KEKO-21-110-111

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Nr. i në	PËRSHKRIMI	Njësia matëse	Sasia	Çmimi pa TVSH për njësi (€)	Totali pa TVSH (€)
1.	Kablo për mbështjellje të tensionit të mesëm 3x35 + 3x25/3, 6/10 kV	m	500		
2.	Kablo për mbështjellje të tensionit të mesëm 3x70 + 3x35/3, 6/10 kV	m	500	55,91	27.955,00
3.	Kablo për konvertor të frekuencave VFC 1kV 3x150+3x70/3	m	500	89,32	44.660,00
4.	Kablo për konvertor të frekuencave VFC 3x120+3x70/3	m	500	115,42	57.710,00
5.	Kablo për konvertor të frekuencave VFC 1kV 3x95+3x50/3	m	500	98,25	49.125,00
6.	Kablo për konvertor të frekuencave VFC 1kV 3x70+3x35/3	m	500	76,04	38.020,00
7.	Kablo për konvertor të frekuencave VFC 1kV 3x25+3x4/3	m	500	59,80	29.900,00
8.	Kablo speciale për mbështjellje-ç' mbështjellje 14 x 2.5+ 6 x 11 M(C) mm², 1kV	m	500	22,81	11.405,00
9.	Kontrolli, sinjalizim dhe bus kablo 2 x 2 x 1 mm²	m	500	29,23	14.615,00
10.	Kontrolli, sinjalizim dhe bus kablo 5 x 2 x 1 mm²	m	500	1,85	925,00
11.	Kontrolli, sinjalizim dhe bus kablo 10 x 2 x 1 mm²	m	500	4,85	2.425,00
12.	Kablo fleksibile gome 7 x 2.5 mm²	m	1500	14,59	7.295,00
				4,73	7.095,00
				Total pa TVSH	291.130,00
				TVSH	52.403,40
				Gjithsejt me TVSH	343.533,40



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.O.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

22-10-2020

Nr.

9385

PRISHTINË-A

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

DHE

BAK - ING SH.P.K

TITULLI: FURNIZIM ME SHËNDRRUES TË FREKUENCAVE

Nr1 i prokurimit: KEK-20-3043-1-1-1

Nr i brendshëm: KEKO-20-233-111

Nr.	Përshkrimi	Prodhuksi model	Vendi i origjinës	Njësia	Sasia	Suma për njësi pa TVSH	Suma totale pa TVSH
1	Ndërpres për mbrojtjen e motorëve PR222DS/P-LSI In=630 ,3p me kontroll elektronike			copë	2		
2	Ndërpres për mbrojtjen e motorëve me rregullim termomagnetik 160A			copë	15		
3	Ndërpres i 250A me njësi LCD ETU,për ç'kyqjen e mbirrymave			copë	4		
4	Ndërpres i 630A me njësi LCD ETU,për ç'kyqjen e mbirrymave			copë	4		
5	Kontaktor i fuqis për ç'kyqjen e motorit 225A			copë	6		
6	Kontaktor 3 polësh 9A, blok me 2 kontakte ndihmëse			copë	10		
7	Kontaktor 3 polësh 460, me blokë kontakte ndihmëse			copë	2		
8	Bobinat – AC/DC AF45 – AF75			copë	6		
9	Bobinat – AC/DC AF95-AF110			copë	6		

Ku nuk shihet asnjë ndërlidhje nuk kane keto kontrata me punët e ngjashme të kërkuara nga AK.Sipas ketyre referencave del qe kjo është një kompani tregtare e materialeve elektrike dhe jo ekzekutuese e punimeve (si lenda në fjalë) krejt keto të bazuara në referencat e prezentuara nga i njeiti,te gjitha këto i themi pasiqe në të gjitha kontratat e prezentuara nuk ka në asnjë prej tyre që ka furnizu as edhe një frekuentor derisa për montim as që behet fjalë pasiqë deshmohet që është kompani tregtare.

Pretendimi 2.Qeshtja tjeter diskutabile është qeshtja e katalogut të prezentuar nga ky OE i propozuar për kontratë.Derisa ky komision i vlersimit mirret deri në detale me katalogun tonë dhe kur vjen puna tek ky OE ne katalogun e tij nuk shihet as edhe nje tip,lloj model i nënvizuar se cilin tip e ka ofertu derisa për katalogun tonë pretendon qe kemi nënvizuar gabimisht!!!!.Kjo edhe me tepër i argumenton dyshimet e bashkëpunimit te ketij komisioni me kete OE.

9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1. Operatori Ekonomik (tenderuesi), me dokumentet e dorëzuara ne oferten/tenderin e tij, duhet te dorëzoje materiale te pergaditura nga prodhuesi, nga te cilat mund te verifikohen te gjitha te dhenat teknike te pajisjeve te kerkuara ne kete aktivitet si ne aneks	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1. Kopje te fletave me te dhena teknike te pajisjeve apo katalogjeve apo manualeve apo broshurave apo skicave dhe vizatimeve, nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, nese ndonje e dhene mungon ne dokumentet e kerkuara-ofruara.
-----------	---	--

Kërkesa do ishte në këtë rast se se me cilin tip te frekuentorit ka ofertu OE i propozuar per kontratë apo “zgjidh e merr” derisa është prezentuar një katalog gjeneral. Keto i argumentojme me katalogun e prezentuar prej 36 faqeve dhe nuk dihet se cili model i ploteson kërkesat teknike të tyre për arsyen se variantet nuk janë të autorizuar dhe mënyren se si e ka kry vlersimin ky komision.



4. Variantet	4.1 Përveç nëse është e shënuar ndryshe në FDT, tenderuesit nuk janë të autorizuar të dorëzojnë tender që propozon ndonjë furnizim i cili është në pajtueshmëri me një variant të specifikimeve teknike.
---------------------	---

Ketu dëshmohen pretendimet tona për këtë vlerësim sepse ne kemi prezentuar tipin,modelin,katalogun dhe të gjitha dhe janë “konstatu” shumë mangësi kur vleresohet ky OE i propozuar për kontratë nuk ka asgjë të nenvizuar dhe për komisionin është gjithqka në “rregull”.

Pretendimi 3:Në këtë pretendim komisioni i vlersimit e konsideron kështu:

Pjesa/Lot 2

Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm për arsye:

1. Përshkrimi i njësisë ngasëse frekuentore (FDU):

Është kërkuar:

Modeli: FDU69-800-23 ose i ngjashëm,

Ju keni ofruar:

ABB ACS880-07-0900A- 7+B054+C130+C164+2L506+V112+V998

Është kërkuar:

Tensioni kryesor: 690 [V]+10%/-15%;

Ju keni ofruar:

525...690 V AC 3-phase ± 10%

Në sqarime shtesë është ofruar një skedar plotësues jashtë katalogut bazë.

Por përkundër kësaj gabimisht është nënvizuar për tipin 07. Pra tipi 07 nuk plotëson kushtin e tensionit -15%.

Tipi i inverterit ABB ACS880-07-0900A-7+B054+C130+C164+2L506+V112+V998

Për këtë tip ... 07.. në sqarimet shtesë është ofruar sipas këtij katalogu =10% (-07,-17,-37,-07CLC,-17/37LC), pra për tipin 07 tensioni është =10% edhe se në katalogun e ofruar në sqarime jashtë katalogut bazë OE ka nënvizuar gabimisht 45 to 2800 kW (-07)

Mains connection

Voltage and power range	3-phase, U_{N2} 208 to 240 V, +10%/-15% (-01)
	3-phase, U_{N3} 380 to 415 V, +10%/-15% (-01, -11, -31), ±10% (-07,-17-37)
	3-phase, U_{N5} 380 to 500 V, +10%/-15% (-01, -11, -31), ±10% (-07,-17-37)
	3-phase, U_{N7} 525 to 690 V, +10%/-15% (-01), ±10% (-07,-17,-37,-07CLC,-17/37LC)
	0.55 to 250 kW (-01)
	2.2 to 110 kW (-11, -31)
	45 to 2800 kW (-07)
	45 to 3200 kW (-17, -37)
	250 to 6000 kW (-07CLC,-17/37LC)

Tipi 07 ± 10%

E nënvizuar gabimisht

Në pretendim thuhet që kemi nënvizuar gabimisht tipin 07 skedaret të ndryshëm, etj, të cilin një komision me dijeni bazike elementare nuk do të bente kesi lloj vlerimese. Këtu pretendimi qëndron në atë që është kërkuar:

- Tensioni kryesor: 690 [V]+10%/-15%;
- Në kemi ofertuar (525-690)V dhe ja shton një AC (nuk dihet ku e kanë vërejtë).

Katalogu i prezentuar nga ana jonë për tipin :

(ACS880-07-900A-7+B054+C130+C164+2L506+V112+V998) është në vazhdim:

Mains connection

Voltage and power range	3-phase, U_{N2} 208 to 240 V, +10%/-15% (-01)
	3-phase, U_{N3} 380 to 415 V, +10%/-15% (-01, -11, -31), ±10% (-07,-17-37)
	3-phase, U_{N5} 380 to 500 V, +10%/-15% (-01, -11, -31), ±10% (-07,-17-37)
	3-phase, U_{N7} 525 to 690 V, +10%/-15% (-01), ±10% (-07,-17,-37,-07CLC,-17/37LC)
	0.55 to 250 kW (-01)
	2.2 to 110 kW (-11, -31)
	45 to 2800 kW (-07)
	45 to 3200 kW (-17, -37)
	250 to 6000 kW (-07CLC,-17/37LC)

Frequency 50/60 Hz ±5%

Power factor
ACS880-01, -07, -07CLC
cos φ = 0.98 (fundamental)
cos φ = 0.93 to 0.95 (total)

ACS880-11, -31, -17, -37, -17/37LC
cos φ = 1 (fundamental)

Efficiency
(at nominal power) ACS880-01, -07, -07CLC, -17/37LC: 98%
ACS880-11, -31, -17, -37: 97%

Motor connection

Environmental limits

Ambient temperature

Transportation	-40 to +70 °C
Storage	-40 to +70 °C
Operation area (air-cooled)	-15 to +40 °C as standard (-01, -11, -31) 0 to +40 °C as standard (-07, -17, -37) +40 to +55 °C with derating of 1%/1 °C (-01, -11, -31) +40 to +50 °C with derating of 1%/1 °C (-07, -17, -37)
(liquid-cooled)	0 to +45 °C as standard (-07CLC, -17/37LC) +45 to 55 °C with derating of 0.5%/1 °C (-07CLC, -17/37LC)

Cooling method

Air-cooled	Dry clean air
Liquid-cooled -07CLC, -17/37LC	Direct liquid cooling, Antifrogen® L

Without liquid-cooling unit
Incoming coolant temperature
0 to +40 °C as standard
+40 to +45 °C with derating of 2%/1 °C
+45 to +50 °C with derating of 2%/1 °C or 6%/1 °C⁵⁾

With liquid-cooling unit
Incoming coolant temperature
0 to +36 °C as standard
+36 to +46 °C with derating of 2%/1 °C

Argumentet tona për këtë pretendim janë si në vazhdim:

Tensioni kryesor është kërkuar: 690 (V)+10%,-15 %

- Prezentuar (525-690)V
- 690 +10%=759 V
- 690-15%=586.5 V
- 690-24% =525 V
- 525-15%=446.25V

Kjo nënkupton që frekuentori i kërkuar punon në kufijtë FDU (586.5-759)V dhe frekuentori i prezentuar ABB ka kufijtë (446.25-759) V dhe ka parametra dukshëm më të gjerë të veprimit.

Që i bie që frekuentori ka karakteristikat +10%,-24% dhe tejkalon vlerat e pretenduara.

Ketu më shumë duhet të besohet që komisioni i vlersimit ka pasë pretendime dhe ka favorizuar OE të propozuar për kontratë sepse keto janë kalkulime të thjeshta matematikore të cilat komisioni i vlersimit as nuk i analizon por deklaron që kemi nenvizuar gabimishtë ku edhe pse ku kufi është akoma më i madhë deklaron që nuk figuron “15%” ku edhe të mirrej si i mirëqenë është kërkuar **ose e ngjashme** dhe është i papranueshëm dhe evident fakti që kemi prezentuar tipin 07 dhe nuk është e qartë se qka ka dashtë ky komision me argumentu me këtë pretendim.

Prandaj ky pretendim **është i pabazuar**.

Pretendimi 4: Ky pretendim prezentohet keshtu:

Eshte kërkuar:

- Frekuenca kryesore: 45 deri 65 [Hz],

Ju keni ofruar:

50/60 Hz ± 5% of nominal frequency

Nga frekuenca hyrëse që është ofruar nga OE për ± 5% e bënë intervalin e punës (47,5 deri 63) Hz që sipas asaj që është kërkuar nuk e plotëson specifikimin teknik – shihe faqen 227 të katalogut

Frequency	50/60 Hz, variation ± 5% of nominal frequency
-----------	---

Tipi jonë i ofertuar është:

45 to 6000 kW (-17, -37)	
250 to 6000 kW (-07CLC, -17/37LC)	
Frequency	50/60 Hz ±5%
Power factor	
ACS880-01, -07, -07CLC	cosφ = 0.98 (fundamental) cosφ = 0.93 to 0.95 (total)
ACS880-11, -31, -17, -37, -17/37LC	cosφ = 1 (fundamental)
Efficiency (at nominal power)	ACS880-01, -07, -07CLC, -17/37LC: 98% ACS880-11, -31, -17, -37: 97%

Ne vazhdim gjeni sqarimin e prodhuesit ABB lidhur me këtë pikë:

Grid code

Explanation regarding frequency tolerance on ABB ACS880 drives

ABB as global supplier of drives and as market leader is supplying AC drives worldwide, where they are used on various applications and industries. With global presence of ABB Drives we are covering majority world grid codes, and this is also tested with IEC standards.

We are not aware of any official grid codes that would require this big frequency deviation from 45 - 65 Hz. Our Drives are tested with 50/60 +/- 5% because some of the most demanding requirements are in Marine segment, but even there they do not require 45 - 65 Hz.

Just for the explanation the IEC standard (IEC 61800-3) is describing the frequency limit +/-2% if the equipment is connected to public network supply and +/-4% where the supply is separated from public supply network. Abb drives are overreaching the requirements since our frequency variation is 50/60 Hz +/-5%.

Table 8 – Minimum immunity requirements for frequency variations on AC power ports of low voltage EUTs

Phenomenon	Residential, commercial or light industrial environment		Industrial environment		Performance (acceptance) criterion
	Reference document	Level	Reference document	Level	
Frequency variation	IEC 61000-4-28	Frequency change: $\pm 2\%$ Transition period between frequencies: 2 s	IEC 61000-4-28	Frequency change: $\pm 2\%$ $\pm 4\%$ where the supply is separated from public supply networks Transition period between frequencies: 2 s	A
NOTE The frequency rate of change is specified according to IEC 61000-4-28. For a transition period of 2 s, a frequency change of $\pm 2\%$ corresponds to a frequency rate of change of $\pm 1\%/s$ and a frequency change of $\pm 4\%$ corresponds to a frequency rate of change of $\pm 2\%/s$.					

In the table below you can see that ABB drives are fulfilling many global requirements/Standards and confirmation of fulfilling the Test Method standard.

Basic Data of the Test					
Ref	Test Case	Requirement (standard/year)	Test Method (standard /year)	Testing Date (dd.mm.yyyy)	Result (pass/fail)
8. Environmental					
1	Power supply variation test (for main circuit)	IEC 61800-3/2004 IEC 60533/2015 ABS 4-9-8/2016 DNV-GL CG-0339-3/2015 LR T.S.No.1/2015 BV C-3-6/2016 CCS GD 22/2015	IEC 61000-4-34/2009	9.5.2018-14.5.2018	Pass
2	Power supply variation test (for auxiliary circuits)	IEC 61800-3/2004 IEC 60533/2015 ABS 4-9-8/2016 DNV-GL CG-0339-3/2015 LR T.S.No.1/2015 BV C-3-6/2016 CCS GD 22/2015	IEC 61000-4-34/2009	23-24.5.2018	Pass

After checking with Product management/R&D, we can confirm that Main circuit can work with the mentioned frequency limit (45-65Hz).

ABB
ABB Inženiring d.o.o.
Bmčičeva 19g, 1231 Ljubljana-Črnuče

Perce

Spjegimi nga prodhuesi ABB:

Ne nuk jemi në dijeni për ndonjë kod rrjeti zyrtar që do të kërkonte një devijim kaq të madh të frekuencës nga 45 - 65 Hz. Pajisjet tona testohen me 50/60 Hz $\pm 5\%$, sepse disa nga kërkesat më të rrepta janë në segmentin detar (Marine), por edhe atje nuk kërkohet 45 - 65 Hz.

Vetëm për shpjegim, standardi IEC (IEC 61800-3) përshkruan kufirin e frekuencës $\pm 2\%$ nëse pajisja është e lidhur me rrjetin publik të furnizimit dhe $\pm 4\%$ kur furnizimi është i ndarë nga rrjeti publik. Pajisjet ABB i tejkalojnë këto kërkesa, pasi varësia jonë e frekuencës është 50/60 Hz $\pm 5\%$.

Pas verifikimit me Menaxhimin e Prodhimit / R&D, mund të konfirmojmë se qarku kryesor mund të punojë me kufirin e përmendur të frekuencës (45–65 Hz).

Bazuar në sqarimin e prodhuesit deshmohet që frekuentori i ofertuar punon në keta kufijë për rastin në fjalë dhe ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 5:

Ne ketë pike në refuzimin e ofertes komisioni deklarohet kështu:

Eshte kërkuar:

- Fuqia për 690 [V],
 - ngarkesë 120%: $P_{nom} = 800$ [kW]; $I = 800$ [A]
 - ngarkesë 150%: $P_{nom} = 630$ [kW]; $I = 640$ [A]
 - $I_{max-60 [s]} = 960$ [A]

Ju keni ofruar:

Për 690 V

ngarkesë 110%: $P_{nom} = 800$ [kW]; $I = 864$ [A]

ngarkesë 150%: $P_{nom} = 630$ [kW]; $I = 673$ [A]

$I_{max-10 [s]} = 1350A$

Mungojne te dhenat per fuqinë nominale për ngarkesë 120% sepse OE ka ofruar këtë fuqi vetëm për ngarkesën 110%

Per ngarkese 150% eshte ofruar per $P_{nom} = 630$ [kW]; $I = 673$ [A]

$I_{max-10 [s]} = 1350A$

Page 214

page 214

ACS880-07-...	Input rating	Output ratings											
		No-overload use					Light-overload use			Heavy-duty use			
		I_1	I_2	I_{\max}	P_N		S_N	I_{Ld}	P_{Ld}		I_{Hd}	P_{Hd}	
		A	A	A	kW	hp	kVA	A	kW	hp	A	kW	hp
U _N = 690 V, 6-pulse connection													
0800A-7	735	800	1200	800	900	956	768	710	800	598	560	600	
0900A-7	827	900	1350	900	1000	1076	864	800	900	673	630	700	

I_{max} është kërkuar për 60 sekonda, ndërsa OE ka ofruar $I_{max-10 [s]} = 1350A$ për 10 s, [shihë faqen 214 të katalogut](#). Pra është kërkuar $I_{max-60 [s]} = 960$ [A] për 60 s, ndërsa është ofruar $I_{max-10 [s]} = 1350A$ për 10 s, gjë që nuk plotëson kërkesën e AK-së. [Shih katalogun tek faqe 215](#)

I_{max}	Maximum output current. Available for 10 seconds at start, then as long as allowed by drive temperature.
-----------	--

OE ka ofruar vetëm të dhënat për 110% janë kërkuar për 120%, si dhe janë ofruar të dhënat për 150%, janë kërkuar 150%.

Ne katalogun e prezentuar per tipin:

(ACS880-07-900A-7+B054+C130+C164+2L506+V112+V998) i cili tip lehtësisht gjindet në faqe të prodhimit në internet dhe të dhenat e tij janë në vazhdim:

$U_n = 690 \text{ V}$ (range 525 to 690 V). The power ratings are valid at nominal voltage 690 V (45 to 2800 kW).											
Drive type	Frame size	Nominal ratings			Light overload use		Heavy-duty use		Noise level (dB(A))	Heat dissipation (W)	Airflow (m³/h)
		I_n (A)	I_{MAX} (A)	P_n (kW)	I_{LG} (A)	P_{LG} (kW)	I_{HG} (A)	P_{HG} (kW)			
6-pulse diode											
ACS880-07-0061A-7	R6	61	104	55	58	55	49	45	67	1795	1750
ACS880-07-0900A-7	D8T + 2xR8I	900	1350	900	864	800	673	630	74	20000	4290
ACS880-07-1160A-7	2xD8T + 2xR8I	1160	1740	1100	1114	1100	868	800	74	26000	5720
Nominal ratings											
I_n	Rated current available continuously without overloadability at 40 °C.										
P_n	Typical motor power in no-overload use.										
Maximum output current											
I_{max}	Maximum output current. Available for 10 seconds at start, then as long as allowed by drive temperature.										
Light overload use											
